

## SHABAN SINANI

**MATTEO MANDALÀ, LEKË MATRANGA: NJERIU,  
KOHA, VEPRÀ,  
Botimet OMBRA GVG, Tiranë, 2013.**

Libri *Lekë Matranga: njeriu, koha, vepra*, është i dyti që studiuesi Matteo Mandalà, një emër i mirënjohur në pararojë të studimeve albanologjike në hapësirën shqiptare e jashtë saj, boton në Tiranë gjatë vitit 2013. Për këtë vepër prof. Mandalà ka punuar që prej mesit të viteve 1980 (saktësisht në vitet 1984-1987), kur ishte student. Botimi i saj në Itali afro një dekadë më parë (2004) u çmua fort prej studiuesve, por nuk e arriti përmasën e një ngjarjeje shkencore publike si në botimin e ri në Shqipëri. Autori vetë, përkthyesi dhe gjuhëtari Gëzim Gurga, si dhe shtëpia botuese *Ombra GvG*, e nxorën veprën përtej ishullit të interesimeve të një urdhri të ngushtë specialistësh, duke realizuar një prej botimeve më cilësore në traditën e librit në Shqipëri dhe duke dëshmuar një kulturë të re librare.

Matteo Mandalà, edhe me këtë libër, dëshmon se është nga ata studiues që shtron dhe zgjidh probleme shkencore që kanë qëndruar para dijes për dekada, ndonjëherë dhe për më shumë. Përveç një studimi të Dhimitër S. Shuteriqit botuar kohë më parë në revistën *Studime filologjike*, për librin e Matragës *E mbsuame e krështerë* nuk kishte ndonjë interesim shkencor të shfaqur as në kohën kur nisën kërkimet e autorit për këtë libër, as kur ai mori vendimin për ta ribotuar në Tiranë. Studimet për librin e dytë në gjuhën shqipe (1592), vetëm katër dekada pas *Mesharit*, tashmë mund të rifillojnë prej një gjendjeje krejt të re.

Në kohën e sotme ekziston një term shumë komod për të emërtuar punën dhe kompetencat ndërdisiplinare që i duhen kërkuesit për të realizuar botime si ky që përurohet sot: *filologji kritike* apo *filologji teksti*. Kjo duket si punë teknike dhe shpesh edhe nuk e merr vlerësimin e vet. Por prapa këtij termi gjenden një mal me vështirësi që duhet të përballojë studiuesi. Në rastin e kësaj vepre çështjet ishin të hapura qysh prej emrit e mbiemrit të autorit: *Lekë* apo *Lukë*, *Matranga* apo *Matrënga* dhe titullit të veprës së tij: *E mbësuar e krishterë* apo *E mbsuame e krështerë*. Duke dhënë zgjidhje për probleme të mëdha e të vogla të kësaj vepre Matteo Mandalà me këtë vepër i ka bërë letërsisë dhe dijes shqiptare të njëjtin shërbim si E. Çabej, N. Ressuli e M. Camaj me *Mesharin e Gjon Buzukut*.

Për këtë vepër mund të thuhet shumë vlerësime, sepse këndet e vështrimit të saj janë të tilla, që do të lejojnë pikëvështrime të larmishme.

Arritja më e rëndësishme e këtij botimi është paraqitja për herë të parë së bashku, në vështrim të krahasuar dhe me zgjidhje të karakterit shkencor: e librit të botuar të Matrangës dhe më pas të zhdukur - dhe ku, në Bibliotekën Apostolike të Vatikanit! - sipas ksomblës që ruhej në Tiranë, si dhe të tre dorëshkrimeve (në fakt, siç provon autori, *janë tre dorëshkrime, por më shumë se tre shkrime dore*), së bashku me të dhënat historike, gjuhësore dhe kronikale për *patronimin Matranga* dhe autorin vetë (*të dhëna që janë të vlefshme jo vetëm për degën arbëreshe të kësaj familjeje*); me historinë e botimit të librit dhe të ruajtjes së dorëshkrimeve; me traditën e studimeve rreth tyre (*prej Marco la Piana-s deri tek brezi i sotëm i studiuesve*); dhe mbi të gjitha me arketipin që frymëzoi botimet e doktrinës së krishterë në gjuhët popullore (Giacomo Ledesma). Kjo vepër është sot *një luks i madh* për brezat e studiuesve të rinj që duan të hyjnë në rrugën e studimeve albanistike, që, fare lehtë, mund të kthehet edhe në një rehati të pamerituar për ta, siç dhe ka ndodhur në raste të ngjashme të zgjidhjes së problemeve të mëdha.

Një prej vlerave më të rëndësishme të këtij studimi të Matteo Mandalà-it lidhet me atë që quhet *ars scribensis*, që shpesh në studimet shqiptare është shpërfillur. Raportet midis kopjuesit dhe autorit, e drejta e kopjuesit si autor, shkruesi si *Bās* i veprës vetë, *il copista come autore* (po të përdornim një shprehje të paleografit palermitan Luciano Canfora), i kanë ngatërruar punët herët e vonë në studimet kodikografike, duke mos përjashtuar dhe *Codice Barberini Latino 3454*, që i përgjigjet si titull reference burimit arkeografik të librit *E mbsuame e krështerë*. Matteo Mandalà, për të krijuar *një hierarki të paqortueshme* jo vetëm midis arketipit dhe variantit shqip, por dhe midis tre dorëshkrimeve dhe tekstit të vetë e librit të botuar, niset prej *shkruesit dhe shkrimit* për të arritur tek autorësia e shkallës së parë dhe për të shkruar më tej tek vënia e tyre në një kronologji historike, gjuhësore dhe kontekstuale.

Një çështje që po shqiptohet gjithnjë e më me qartësi në studimet shqiptare është ajo e *historisë së alfabetizimit dhe grafematizimit të gjuhës shqipe*. Duke qenë i dyti libër i shkruar në shqip dhe duke qenë në duart e një mjeshtri të punës ngulmuese njëherësh në shumë drejtime si Matteo Mandalà, *E mbsuame e krështerë* shenjohej si një prej referencave themelore në këtë proces dhe tashmë është e mundshme që pikërisht përmes atij që e quajtmë *ars scribensis* të arrihen kërkime të reja për gjendjen gjuhësore dhe kulturore e letrare të shqiptarëve të Italisë një shekull pasi ishin vendosur në mjedisin e ri demografik; për raportet midis arbërishtes së Horës *siç ishte në krye* me toskërishten, për raportet midis dy dialekteve bazë të shqipes, gegërisht e toskërisht, që bashkohen e ndahen qysh në shekullin e 8-të, si dhe për shumë çështje të tjera.

Përveçse për vlerat gjuhësore dhe letrare, mendoj se është me vend të pohohen edhe vlerat kishtarë të këtij botimi, në kontekstin që, siç e pohon me

të drejtë M. Mandalà, arbëreshët, grekët dhe popullsi e grupime të tjera të krishtera në jug të Italisë, që i mbaheshin ritualit lindor në liturgji, me sytë e autoriteteve kishtarë të vendit shiheshin si *heretikë*. E mbsuame e krështerë në këtë pikëpamje përbën një hap mëvetësimi me rëndësi jo vetëm doktrinare, por edhe kombëtare për arbëreshët.

Së fundmi, duhet thënë se, ashtu si vepra e Lekë Matrangës i jep autoritet historisë së shqipes së shkruar, ashtu puna e Matteo Mandalà-it dhe e Francesco Altimarit, dy bashkëdrejtues të suksesshëm të kolanës *Klasikët e letërsisë arbëreshe*, që i përket botimi, i jep dinjitet gjithë dijes shqiptare.

